

A N A L O G J I A

Kuptimi i analogjisë në drejtësi

Në drejtësi analogjia në kuptimin e gjerë paraqet zgjidhjen e marrëdhënieve shoqërore në bazë të normave që rregullojnë marrëdhënie të ngjashme.

Kuptimi i analogjisë në të drejtën penale

Analogjia në të **drejtën penale** paraqet rastin kur një vepër që nuk është e paraparë me ligj si vepër penale, konsiderohet si e tillë në bazë të ngjashmërisë me veprën penale.

Lejimi i analogjisë sipas disa legjislacioneve pas luftës së dytëbotërore

Në të drejtën penale të ish shteteve socialiste të Evropës edhe në Republikën e Shqipërisë dhe në ish Federatën Jugosllave , pas Luftës së dytë Botërore, ka qenë e lejuar analogjia , ngase ekzistonin zbrazëtira të mëdha juridike. Analogjia në këtë periudhë lejohej meqë e drejta penale nuk ishte e kodifikuar, kurse për shumicën e inkriminimeve aplikoheshin rregullat e paraluftës. Mirëpo me nxjerrjen e kodeve penale të ish Jugosllavisë 1951 dhe 1952 nën sovranitetin e të cilës ishte edhe Kosova gjere më 12.6.1999, u bë kodifikimi i së drejtës penale dhe prej atëherë u ndalua **analogjia**.

Ndalimi i analogjisë sipas KPK –neni 1.par.1.

Analogjia si mënyrë e krijimit të veprave të reja penale është e ndaluar në të drejtën penale ngase është në kundërshtim me parimin e legalitetit, edhe në KPK është inkorporuar ky parim ku në nenin 1.par.1. ku thuhet “Veprat penale, sanksionet penale dhe masat e trajtimit të detyrueshëm përcaktohen vetëm me ligj”.

Me anë të analogjisë gjithashtu nuk mund të zgjerohet as elementet apo rrethanat kualifikuara dhe të privileguara në veprat tjera penale. Me anë të analogjisë nuk mund të sajohen as sanksione të reja penale. Këto kufizime vlejné për aplikimin e analogjisë , pa marr parasysh a janë në dëm të kryesit të veprës penale (analogjia **in malampartem) apo në favor të tij(analogjia **in bonampartem**). Gjithashtu me analogji nuk mund të bëhet as ashpërsimi i dënimeve.**

Analogjia si mënyrë e interpretimit të ligjit në favor të pandehurit

Analogjia e lejuar. Në të drejtën penale konsiderohet se është e lejuar analogjia po që se ajo është në favor të tëfajësuarit dhe nëse interpretimi i tillë nuk është në kundërshtim me normat dhe parimet e tjera penalo-juridike. Kjo mund të shprehet në rast kur është fjala për bazat apo:

- **rrethanat e përjashtimit të veprës penale dhe ndëshkueshmërisë ,** nga se kjo fushë në masë të madhe nuk është e rregulluar me ligj
- **Madje analogjia është e lejuar në rastet kur ekzistojné rrethana për zbutjen e dënimit si dhe në përgjithësi në situata kur kryesi i veprës penale vihetné pozitë më të favorshme(analogjia in bonampartem),** që mbështet në parimin in dubi pro reo.

Analogjia si mënyrë e interpretimit të ligjit në favor të pandehurit sipas PKP.1-3

Analogji si mënyrë e interpretimit në favor të kryesit të veprës penale, **në mënyrë decisive është e paraparë në KPK neni 1.par.3. ku thuhet “Në rast paqartësie përkufizimi i veprës penale interpretohet në favor të personit i cili hetohet, akuzohet ose shpallet fajtor”.**

Analogjia kur ligji shprehimisht parasheh njëmundësi të tillë

Analogjia në të drejtën penale lejohet edhe në rastet kur edhe vetë ligji në mënyrë shprehimore udhëzon aplikimin e saj edhe në situatat që janë të ngjashme me ato që parashihen në figurën e veprës penale. Kjo veçmas shprehet në dispozitat e kodit penale , në të cilat figura e veprës penale përcaktohet edhe me të **ashtuquajturën klauzola gjenerale**.

Psh. Dispozita e nenit 218 par.1 të PPK, parashihet si vijon "Kushdo që, në kundërshtim me ligjin e shëndetësisë, në spital, maternitet të spitalit, shkollë apo restorant apo punëtori në të cilën përpunohen artikuj ushqimor apo e cila kryen shërbime higjienike apo në organizatën e biznesit **apo vend të ngjajshëm pune** , e punëson apo e mban në punë personin për të cilin e di se lëngon nga smundja ngjitëse dhe me këtë shkakton përhapjen e sëmundjes dënohet gjobë ose burgim deri në një vit.

Analogjia e ndaluar

Analogjia është e ndaluar në të drejtën penale , po që se sipas normës së caktuar penalo-juridike bëhet subsimimi i veprës apo rastit i cili nuk është i paraparë me ligj dhe poqëse duhet të tejkalohet apo zgjerohet vëllimi i normës nëse dëshirohet që edhe ai rast të përfshihet me normën e caktuar.

Pra në rastet kur tejkalohet kufiri i kuptimit të normës që është përcaktuar edhe me anë të interpretimit atëherë shprehet analogjia e ndaluar. Do të ishte psh. analogji e ndaluar rasti kur ndonjë person dënohet për vepër penale të vjedhjes, poqëse është ushqyer në restorant, mirëpo nuk ka pasur të holla të paguajë.